

Në këtë mbledhje të fillimit të vitit, pati një pjesëmarrje të lartë dhe prurje të reja të anëtarëve të Bordit Teknik, miratuar nga Bordi Drejtues, përfaqësues nga biznesi, akademja dhe ekspertë të fushës, prej katër (4) anëtarësh të rinj, duke tentuar përfshirjen e anëtarëve aktivë në punën teknike.

Z. Gentian Gjyzezi, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Standardeve prezantoi programin e punës së DS për miratimin e standardeve të reja, për 6 mujorit parë të vitit 2017 dhe ndryshimet në Komitetet Teknike, vënë në dispozicion paraprakisht për anëtarët e BT.

Gjithashtu, në lidhje me propozimet për ndryshime në Komitetet Teknike, u paraqitën kërkesa të reja për pjesëmarrje në punën e Komiteteve Teknike. Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të eksperiencave të tyre, u vendos përfshirja në Komitete Teknike (KT) të rëndësishme, si anëtar të rinj, **KT 230** "Uji, ajri dhe toka", **KT 114** "Siguria e makinerisë dhe siguria ndaj zjarrit" dhe **KT 305** "Atmosfera shpërthyesë – Parandalimi i shpërthimit dhe mbrojtja".

Pas shqyrtimit të listave me standardet e propozuara për miratim dhe propozimet për ndryshim në Komitetet Teknike, anëtarët e Bordit Teknik miratuan:

- *Programin e Punës për 6-mujorin e parë të vitit 2017;*
- *Përbërjen e Komiteteve Teknike.*

Mbledhja e radhës e Bordit Teknik për miratimin e programit të punës të DPS për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2017, do të mbahet javën e parë të muajit Korrik.

DPS, Tiranë - 23 Janar 2017